

Tirane, me __/__/2017

**Drejtuar: Agjencise Kombetare te Mjedisit, ARM, Tirane
NJQV Kamez, Tirane**

Lenda: Njoftim Per Informim Dhe Pjesëmarrje Te Publikut Për Proceduren E Aplikimit Për Leje Mjedisi Të Tipit B Per Aktivitetin “Fonderi Per Shkrirje Skrapi Alumini” Te Kompanise EVEREST Shpk, Kamez, Tirane

Bazuar ne Ligjin Nr. 10431, date 09.06.2011 “Per Mbrojtjen e Mjedisit”, Ligji Nr. 10448, date 14.07.2011 “Per Lejet e Mjedisit”, Ligjin Nr. 60/2014, date 19.06.2014 per nje ndryshim ne ligjin nr. 10448, date 14.07.2011 “Per Lejet e Mjedisit”, te ndryshuar me VKM 419, date 25.06.2014 “Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipeve A,B, dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit, si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKB”, Kreu VI “Informimi dhe pjesmarrja e publikut per aplikimin per leje mjedisi te tipit A dhe B”, pika 2 Kompania EVEREST sh.p.k me NIPT J78311921L, njofton Agjencine Kombetare te Mjedisit, ARM dhe NJQV Kamez Për Proceduren E Aplikimit Për Leje Mjedisi Të Tipit B per Aktivitetin “Fonderi Per Shkrirje Skrapi Alumini”.

Kompania EVEREST sh.p.k (me poshte po e citojme vetem Everest) eshte rregjistruar prane QKR (sot QKB) date 30/03/1998, me NIPT J78311921L dhe perfaqesues ligjor z. Sokol Çupi. Aktualisht EVEREST ushtron aktivitetin per prodhimin dhe lyerjen e profileve te duraluminit, ne zonen industriale Kamez e lokalizuar prane nyjes se betonit, ne adresen zyrtare: “Fabrika ne Rrugen Nacionale, Prane Nyjes se Betonit, Kamez, Tirane”, me fasade dhe dalje ne rrugen nacionale Kamez- Tirane. Se fundi EVEREST, brenda ambienteve te kompanise, ka investuar ne nje linje teknologjike te fjales se fundit per riciklimin e mbetjeve teknologjike – skrap alumini qe gjenerohen kryesisht nga aktiviteti I saj. Linja eshte Fonderi per shkrirje skrap alumini, per te cilen EVEREST aplikon per Leje Mjedisi tipi B.

EVEREST sh.p.k ne kuader te Aplikimit për leje mjedisi të tipit B prane QKB-se per aktivitetin –Fonderi per shkrirje skrap alumini, qe sipas Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, sipas kollonës 1 dhe 2, **ka përshkrimin e veprimtarisë - Prodhim Dhe Perpunim I Metaleve** , ID 2.5 pika b. **Shkrirja dhe përftimi i aliazheve të metaleve joferrose (me ngjyrë) përfshirë produktet e rikuperuara (duke përfshirë rafinimin dhe derdhjen në fonderi).**

Fonderia per shkrirje skrap alumini ndodhet brenda ambienteve te Kompanise EVEREST ne nje objekt te tipit “Kapanon me Konstruksiione Metalike”, per ndertimin e te cilit eshte

pajisur me pare nga Ministria e Mjedisit me VNM. Fabrika e perpunimit te skrapit te aluminit ndodhet ne vazhdim te linjave ekzistuese te kompanise, ne adresen: Fabrika ne Rrugen Nacionale, Prane Nyjes se Betonit, Kamez, Tirane.

Parcela/trualli ku eshte ngritur objekti per Fonderine e kompanise EVEREST, eshte prone e kompanise dhe aksionereve. Të dhënat për pronësinë e tokës sipas dokumentit të lëshuar nga ZRPP jane: Zona kadastrale 2066, Nr pasurie 83/231, Vol. 53, Faqe 135 dhe Nr pasurie 83/216, Vol. 45, Faqe 89.

Pronaret te truallit jane: Everest shpk dhe aksionieret e EVEREST kompani.

Me poshte ortofoto ku ndodhet EVEREST shpk



Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4 jane si me poshte:


	Eastig	Northing
Pika 1	4396394.63	4584820.15
Pika 2	4396467.75	4584849.51
Pika 3	4396497.39	4584788.28
Pika 4	4396425.14	4584757.12
Qendra Parc.	4396445.49	4584798.86

PLANI I VENDOSJES SE STRUKTURES SH. 1:1000

Struktura : " Kapanon i Fonderise "

Investitor : Shoqeria " EVEREST" sh.p.k


Ne prone te shoqeria " EVEREST" sh.p.k , me nr. pasurie 83/216 dhe ne prone te (Hajredin Isuf Valter , Ilir Hamdi Cupi, Kujtim Hajredin Valteri, Sokol Hamdi Cupi) me nr. pasurie 83/231; Rruga "Bulevardi Blu" , Kamez , Tirane



Reshetja topografike shk. 1:5000

Reshetja hartes kadastrale shk. 1:2500

Pozicioni topografik i zones shk. 1:5000



Pozicioni i hartes kadastrale shk. 1:2500



Objekti "Kapanon me Konstruksione Metalike" I ndertuar per fonderine eshte konceptuar te jete i perbere nga kapanone me dy pjese ne forma drejtkendore ku secila pjese respektive eshte me siperfaqe totale prej **1278** m², me dimensione respektive **48.1m** x **21m** dhe lartesi **13.45** metra, dhe 13.6m x 19.8m me lartesi 9.6m. Objektet qe perbejne fabriken jane teresisht te reja. Ato jane konceptuar ne menyre te tille qe te gjitha funksionet te kryhen me cikel te mbyllur, duke filluar nga magazinimi i lendes se pare (skrap alumini) dhe deri ne ate te produktit te gatshem qe jane lingotat e aluminit.

Fonderi per shkrirje skrapu alumini eshte parashikuar te kete nje kapacitet perpunimi deri ne 20 ton ne dite. Linja do punoje ne menyre te pa nderprere gjate gjithe vitit me perjashtim te diteve te remonteve.

Gjate procesit te prodhimit nuk perdoren lende ose substanca te rezikshme.

Punesimi

Me venien ne pune te ketij investimi EVEREST do ndikojë pozitivisht ne komunitetin pereth duke zbutur papunesine. Per kryerjen e aktivitetit prodhues ne kete linje prodhimi parashikohet te punojne 34 persona nga te cilet:

- 1- Inxhinier fabrike 1
- 2- Pergjegjes prodhimi 3
- 3- Magazinier 1
- 4- Ne mirembajtje 4
- 5- Punetor ne prodhim 25

Duhet te theksojme qe ne projektimin e Fonderise per shkrirje skrapu alumini jane mbajtur ne konsiderate kerkesat per sigurine ne pune te punonjesve qe do te punojne aty, kerkesat per sigurimin teknik, kerkesat mjedisore ne lidhje me kushtet ne mbrojtjen e ambientit dhe mjedisit. Ne te gjitha proceset e punes do te zbatohen me rigorozitet kushtet e sigurimit teknik dhe cdo kerkese e legjislacionit ne fuqi.

Përshkrimi i veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim

Procesi teknologjik


Linja teknologjike e Fonderise per shkrirje skrapu alumini e EVEREST shpk, përbëhet nga:

- Kapanoni ku vendosen te gjitha makinerite kryesore te procesit te shkrirjes se aluminit dhe ato ndihmese.
- Magazina e produktit përfundimtar.
- Depozitat e ujit.
- Kompresor, Gjenerator, Transformator.
- Depozita e gazit.
- Filtrat qe bejne te mundur pastrimin e tymit dhe thithjen pluhurit qe gjenerohet nga furra.

Procesi teknologjik kryhet sipas rendit te proceseve te listuara dhe skemes teknologjike me poshte:

1. Vendi i grumbullimit te skrapit
2. Procesi i perpunimit te skrapit
3. Fura e shkrirjes
4. Filtri & aspiratori
5. Depozitat e ujit
6. Pusi i derdhjes se lingotes
7. Sistemi i prerjes se lingotes
8. Furra e homogjenizimit
9. Furra e ftohjes
10. Peshorja
11. Depozita e gazit
12. Kompresori
13. Transformatori
14. Gjeneratori
15. Laboratori
16. Piruni i transportit te lingotave
17. Kulla e avullimit

Ref. Skema teknologjike dhe fotot.





Magazinimi i lëndëve të para. Në Fabrikën perpunimit të skrapit të aluminit “EVEREST” aplikohet teknologji e kohëve të fundit. Kompania i siguron lëndet e para nga mbetjet që gjenerohen nga aktiviteti i procesit të prerjes së profileve të aluminit për prodhimin e produkteve të ndryshme si edhe nga grumbullimi i skrapit të aluminit (për të cilin është e licencuar me pare nga Ministria e Mjedisit).

Magazinimin e skrapit të aluminit . Cikli i prodhimit në fonderinë e shkrires së skrapit të aluminit fillon me magazinimin e skrapit të aluminit. Lëndet e para, skrap i aluminit, grumbullohet dhe sistemohet në një ambient të organizuar pranë objektit të fonderisë, nga ku me pas bëhet pastrimi i skrapit të aluminit nga papastertitë të tipit: të hekurit, plastikave, shkuma, gome, mundësisht edhe nga boja e profileve etj.

Pastrimi i skrapit të aluminit nga papastertitë . Ky pastrim bëhet nëpërmjet një linje që ka një makineri të quajtur SHREDER (mulli), ku bëhet copetimi/grirja e skrapit të aluminit. Me pas bëhet ndarja e aluminit nga plastika dhe hekuri. Ndarja e hekurit nga alumini bëhet nëpërmjet një magneti të fuqishëm dhe të përhershëm që rri mbi një transportier ku kalon alumini i grirë. Pas këtij procesi alumini i përfutur bëhet gati për të hedhur në furnen e shkrires.

Pergatitja e produktit perfundimtar-lingota. Poces i prodhimit të produktit perfundimtar, që është lingota e aluminit, realizohet nëpërmjet shkrires në furne të copezave të aluminit të përfutura nga procesi i pastrimit dhe copezimit. Në përgjithësi temperatura e shkrires së aluminit mbahet 730-740 °C, kjo edhe në varesi të kushteve atmosferike. Kjo temperatura arrihet nëpërmjet dy djegesave/brucatoreve që punojnë me djegie me gaz. Gazi i përdorur është propan-butan i lengshëm. Gjate kohës që shkrihet skrap i aluminit në furne here pas here merren kampione dhe analizohen në pajisjen e laboratorit të quajtur Kuantometer, me anë të të cilës përcaktojmë nëse lidhja e aluminit është në rregull apo jo. Ambienti ku bëhet shkrepja për të përcaktuar përberjen kimike të kampionit bëhet në gaz inert (argon). Në bazë të analizës që del për përqindjet e elementeve të vecante bëhet edhe korigjimi i lidhjes me elemente të pastër siç është silici, magnezi, bakri, mangani, etj.



Ne momentin qe furra ka arritur tonazhin e percaktuar dhe lidhja e aluminit eshte rregulluar dhe alumini i shkrirë eshte gati per shkarkim ne pusin e marrjes se formes se lingotes (billete) atehere behet degazifikimi i aluminit nepermjet gazit te Argonit (behet nepermjet nje seti bomblash argoni) me qellim qe te largohet hidrogjeni prezent ne alumin dhe ai i skorieve te tjera.

Degazifikimi behet ne kete menyre: nga seti i bomblave te argonit nepermjet nje tubi fleksibel gome transportohet gazi ne nje tub celiku inoks qe duron temeperatura te larta, i cili futet ne banjen e aluminit per te bere te mundur zhvendosjen e gazit te argonit nga seti i bomblave ne banjen e aluminit te shkrirë. Ne kete menyre ne qofte se ne banjen e aluminit kemi te pranishem hidrogjen dhe skorje te tjera ato do te dalin ne sipërfaqe bashke me gazin e argonit qe kemi future ne kete menyre behet edhe nje omogjenizim me i mire i banjes se aluminit para se te behet shkarkimi.

Pas shkarkimit te lengut te aluminit ne pusin e lingotes behet ulja e fures nga ana e operatorit.

Pas derdhjes se aluminit nga furra bacino ne pusin e lingotes behet ftohja e lingotes brenda pusit nepermjet ujit qe sigurohet nga depozitat qe jane 2 m larg pusit. Nga ky uje qe perdoret per ftohjen e lingotes 50 % avullon, kurse pjesa e ngelur rikthehet ne sistemin e vaskave ku behet njekohesisht perzierja me ujin qe ndodhet ne vaska dhe ftohja. Ne kete menyre krijohet nje cikël i mbyllur i ujit qe perdoret per ftohjen e lingotave, qe do te thote nuk kemi ndotje. E para sepse procesi i ftohjes se lingotave nuk eshte nje proces qe shoqerohet me ndotjen e ujit dhe se dyti duke qene se eshte nje process i mbyllur nuk kemi shkarkim te ujrave ne rrjet apo ne ambient. Pas daljes nga pusi lingotat kalojne ne linjen e prerjes standarte te lingotave (billete) nepermjet pirunit te montuar ne pozicion fiks. Prerja i behet lingotes ne fillim dhe ne fund per te perfituar nje gjatesi standarte, pas kesaj prerje lingotat kalojne ne furren e homogjenizimit.

Trajtimi ne furren e homogjenizimit behet duke e vendosur temperaturen e fures, respektivisht edhe te lingotave ne nje temperature me te vogel se ajo e shkrirjes. Me saktesisht temperatura ne furren e omogjenizimit vendoset nga 580-585 °C, dhe mbahet ne kete nivel per nje kohe rreth 6 ore.

Keshtu ngarkesa e lingotave te homogjenizuara futen ne nje dhome ftohjeje ku nuk rrine me shume se 2 ore, duke ju bere nje ftohje e shpejte per te arritur keshtu nje omogjenizim te struktures molekulare. Pas daljes nga dhoma e ftohjes lingotat (billete) jane gati per tu vendosur ne ambjentin e stokut.

Manaxhimi I Pakesimit te ndotjes dhe sistemet te rikuperimit

Per pakesimin e ndotjes fonderia eshte e pajisur me sistemin e filtrave pluhur kapes, qe bejne te mundur kapjen e tymit dhe te plurave nga fondeira. Tymrat dhe plurat e gjeneruara nga furra e shkrirjes kalojne nepermjet sistemit te tubave prej celiku ne filtrin e fonderise. Pastrimi i kemishave te filtrit behet nepermjet ajrit te komprimuar qe merret nga kompresori dhe ujit. Ky proces ben te mundur qe ne oxhakun e fonderise te mos dali tym i ndotur dhe te beje ndotjen e ambjentit. Uji qe ben shplarjen e kemishave te filtrit derdhet ne kanalim e ujrave te zeza.

Ky uje nuk eshte i ndotur dhe i rrezikshem sepse skrapit i aluminit qe shkrihet eshte i pastruar me pare nga elementet qe mund te shkaketojne ndotje nga djegia e tyre sic jane plastika, goma etj.

Skorja e gjeneruar nga ky proces depozitohet ne vendin e percaktuar e gatshme per tu rishkrirje. Kjo skorje nuk eshte ndotese ambjenti sepse eshte thjesht alumini i shkrirje ne trajte shkume me nje perqindje te caktuar alumini, qe ka interes per tu rishkrirje. Sasia e ketyre skorjeve gjenerohet ne varesi te punes qe behet tek furra, ne qofte se furra punon me kapacitet te plote sasia e ketyre skorjeve mund te jete maksimumi rreth 20-40 ton ne muaj. Ndersa per skorjet qe nuk mund te riciklohen me, kompania ka lidhur kontrate me nje kompani per largimin e tyre.

Ruajtja e lendeve te para

Lendet e para (skrapit i aluminit), paamvaresisht nga burimi qe sigurohen, kontrollohen mire para se te futen ne ambjentin ku eshte percaktuar magazinimi i tyre ne fabrike. Pasi ju eshte bere kontrolli dhe nuk rezultojne me probleme atehere ato magazinohen dhe vendosen ne vendin e percaktuar ne pritje per tu ngarkuar ne furren e shkrirjes.

Materialet ose lendet qe perdoren si ndihmese jane kryesisht ato qe vijne nga importi, gazi, metalet qe perdoren si shitesa sic jane (silici, bakri, magnezi, mangani) etj.

Fonderia ka te gjitha rrjetin e nevojshem kullues per te mbajtur lendet e para dhe ato ndihmese ne nje ambient sa me normal pa lageshtire. Te gjitha ambjentet ne fabrike jane te shtruara me beton per te krijuar kushte sa me te mira pune per punonjesit dhe per te patur nje rendiment sa me te larte.

Ne fabrike zbatohen te gjitha masat e sigurimit teknik per punonjesit, dhe futja e te huajve ne ambientet e fabrikes eshte e ndaluar rreptesisht, vetem ne rastet e marrjes se lejes nga personat e autorizuar.

Lendet e para dhe ndihmese

Lendet e para

Lenda e para qe perdorent ne fabriken e perpunimit te skrapit te aluminit qe sigurohen nga tregu vendas dhe ai i importit jane te shoqeruara me informacionin e nevojshem. Si lende te para perdoren:

- Skrap alumini i llojeve te ndryshme (skrap profilesh alumini, teli, alumini i bute, pjese motorri te makinave, kabina makinash etj.)

Lendet ndihmese

Ne fabriken e perpunimit te skrapite te aluminit “EVEREST” shpk perdoren nje sere materjalesh ndihmese, te cilat grupohen:

- Uji
- Energjia elektrike.
- Gazi qe perdorin brucatoret per shkrirjen e skrapit te aluminit.
- Gazi (Argon) qe perdoret per degazifikim dhe per pajisjen e laboratorit.
- Metalet e paster si: silic, baker, magnez, mangan qe sherbejne per rregullimin e lidhjes se aluminit.

Energjia elektrike

Energjia elektrike sigurohet ne te dyja format; nga rrjeti shperndares i energjise elektrike nepermjet kabines elektrike dhe nga nje gjeneratore. Brenda ne objekt per aktivitetet ndihmese eshte ndertuar nje panel elektrik. Fuqia e instaluar per te gjitha fonderiane eshte 600 KW.

Gjeneratoret jane ne gjendje te mire pune, dhe perdorin si karburant naften. Duhet te ritheksojme se per funksionimin e fabrikes perdoret vetem energji elektrike nga rrjeti i OSHE.

Uji

Uji qe perdoret per ftohjen e lingotes sigurohet nga burime vetijake. Fabrika eshte e paisur me disa vaska (depozita) me kapacitet rreth 700 m³ uje. Per dergimin e ujit ne pusin e ftohjes se lingotave eshte instaluar nje stacion pompimi.

Mbetjet qe gjenerohen nga prodhimi i produktit perfundimtar-lingotat e aluminit

Mbetjet qe gjenerohen nga prodhimi i lingotave jane kryesisht mbetje te ngurta- ne formen skorjes se aluminit, dhe mbetje te lengeta ne formen e ujrave te larjes dhe te ujrave te zeza.

Mbetjet e ngurta

Mbetjet qe gjenerohen nga prodhimi i lingotave jane kryesisht mbetje ne formen skorjes se aluminit ose si te themi ne trajten e shkumes se aluminit. Permbajtjet e tyre jane alumin. Keto mbetje grumbullohen ne vendin e caktuar me qellimin e vetem per ti perdorur per rishkrirje.

Mbetjet perfundimtare qe mund te dalin ne fund te procesit teknologjik, jane te tipit skorie alumini, te cilat kompania i depoziton ne ambientin e pershtatur per to brenda ne ambientet e kompanise. Per largimin/evadimin e tyre nga ambientet e fabrikes, kompania EVEREST ka lidhur kontrate me kompanine B-Rametal shpk qe ben terheqjen e tyre me mjetet e veta. (Ref. Kontrates blerjes midis kompanise EVEREST & B-Rametal shpk)

- Emri: skorie alumini
- Përshkrimi dhe natyra e mbetjes: Mbetje me natyre metalike
- Burimi: Fabrike
- Ku magazinohet dhe karakteristikat e hapësirës së magazinimit: Fabrike/piken e grumbullimit
- Sasia/volumi në ton dhe m³: deri ne 40 t.
- Periudha(t) e gjenerimit: 12 muaj.
- Analizat (duke përfshirë testimin dhe metodat e sigurimit të cilësisë):
- Kodi sipas listave të mbetjeve referuar legjislacionit Shqiptar mbi Kategoritë e Mbetjeve. *Kodi unik ne emer te subjektit EVEREST shpk eshte EVE0017 (ref. shkreses se AKM-se nr. 1835 prot e dates 07.10.2015 me Lende: Miratimi i kodit unik per transportimin e mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rreziksme)*

Mbetjet e lengeta.

Mbetjet e lengeta jane ne formen e ujrave te larjes dhe te ujrave te zeza. Ato derdhen kanalizimet e ujrave te zeza sepse jane te pa demshme. Aktualisht, tualetet ndodhen brenda nderteses se administrates. Tualetet kane kanalizime dhe ujrat shkarkohen ne kanalet e ujrave te zeza nepermjet kanaleve dhe tubacioneve per ne rrjetin e kanalizimeve te zones.

Asgjesimi I Mbetjeve Jashtë Instalimit

E vetmja mbetje qe gjenerohet gjate procesit teknologjik te prodhimit te lingotave te aluminit eshte skorja qe perfitohet nga furra e shkrijes bacino. Keto jane mbetje te pa rrezikshme, te cilat kompania i depoziton ne ambientin e pershtatur per to brenda ne ambientet e kompanise. Keto mbetje e skorieve te aluminit perdoren kryesisht per rishkrirje nga kompani te tjera qe jane te specializuara per perpunimin e skorjeve te kesaj natyre.

Per largimin/evadimin nga ambientet e fabrikes te mbetjeve perfundimtare qe dalin ne fund te procesit teknologjik, qe jane te tipit skorie alumini, kompania EVEREST ka lidhur kontrate me kompanine B-Rametal shpk qe ben terheqjen e tyre me mjetet e vet.

Shkarkimet E Mundshme

Shkarkimet Fluruese

Procesi teknologjik nuk ka shkarkime te komponimeve organike te avullueshme, por per aktivitetin teknologjik te saj kjo fonderi eshte apjisur me nje sistem aspirimi dhe filtra perthithjen e tymit dhe pluhurave te gjeneruara nga furra e shkrirjes se skrapit te aluminit.

Tymrat dhe pluhurat e gjeneruara nga furra e shkrirjes kalojne nepermjet sistemit te tubave prej celiku ne filtrin e fonderise. Pastrimi i kemishave te filtrit behet nepermjet ajrit te komprimuar qe merret nga kompresori dhe kalimit ne uje. Ky proces ben te mundur qe ne oxhakun e fonderise te mos dali tym i ndotur dhe te beje ndotjen e ambientit, por te dali i paster pa ndotje.

Uji qe ben shplarjen e kemishave te filtrit derdhet ne kanaline e ujrave te zeza. Ky uje nuk eshte i ndotur dhe i rrezikshem sepse skrapit i aluminit qe shkrihet eshte i pastruar me pare gjate procesit te pergatitjes se lendeve te para ku behet ndarja nga material me perberje jo-alumini, si rezultat skrapit I aluminit qe futet per shkrirje eshte I paster nga elementet qe mund te shkaketojne ndotje nga djegia e tyre sic jane plastika, goma etj.

Shkarkimet ne ujerat siperfaqesore

Si rezultat i proceseve teknologjike, sikurse shihet edhe nga pershkrimet me siper nuk ka shkarkime ne ujerat siperfaqesore.

Shkarkime Ne Rrjetin E Kanalizimeve

Sic e kemi pershkruar edhe me lart, zona ku ndodhet fabrika ka rrjet te kanalizimeve te ujrave te bardha e te zeza. Ujrat siperfaqesore (ne periudha shirash) jane te sistemuara nepermjet kanalizimeve dhe derdhen ne kanalet e ujrave te zeza. Ne siperfaqe te perimetrit te sheshit dhe te rrugicave te fabrikes jane ndertuar puseta dekantimi te cilat pastrohen periodikisht.



Shkarkime Ne Toke

Gjate procesit te prodhimit te lingotave nuk gjenerohen shkarkime ne toke qe te ndikojne ne ujrat nentokesor.

Shkarkimet e zhurmes

Paisjet teknologjike qe perdoren per prodhimin e lingotave te aluminit nuk gjenerojne zhurma. Zhurma mund te shkaktohen nga levizja e makinave, renia e burive ose nga ventilatoret ftohes ose gjenerues ajri.

Vibracionet

Paisjet teknologjike qe perdoren per prodhimin e lingotave nuk gjenerojne vibracione pervec mjeteve levizese si kamione, pirune ngarkim-shkarkimi etj, qe mund te shkaketojne dridhje te vogla te ambjentit ku levizin.

Rezatimi JO-JONIZUES

Gjate procesit te prodhimit, sic e kemi thene dhe me lart nuk perdoren paisje qe emetojne rezatim jo jonizues. Ky lloj rezatimi ka natyre valore elektromanjetike. Rezatimi jo jonizues perfshin rezatimin e linjave elektrike (ELF), dhe paisjeve elektrike elektroshtepiake, radiovalet, mikrovalet, rezet infra te kuqe dhe pjeserisht ultraviolet.

Gjendja e Vendndodhjes

Cilesia e ajrit

Kompania EVEREST sh.p.k e rregjistruar prane QKR-se me NIPT J78311921L, aktualisht ushtron aktivitetin ne prodhimin dhe lysterjen e profileve te duraluminit, si dhe ne grumbullimin transportimin dhe rruajtjen e mbetjeve te aluminit, lokalizuar ne zonen industriale prane rruges nacionale Kamez, prane nyjes se betonit, Tirane.

Tereni rreth fabrikes eshte i veshur me bimesi spontane, dhe te kultivuar. Nga aktiviteti i fabrikes, nga vete teknologjia qe perdoret, pervec avullit nuk gjenerohen shkarkime te demshme ne ajer.

Sa me siper ne kete zone nuk ka ndotes se ajrit nga aktiviteti i fabrikes, pervec pluhurit dhe gazrave ne atmosfere nga shkarkimet e transportit ne rrugen nacionale Kamez-Tirane.

Ujrat siperfaqesor dhe nentokesor, hidrologjia.

Ne zonen e ku eshte ndertuar fabrika nuk ka burime siperfaqesore. Perreth kesaj zone nuk ka zona te lundrushme, nuk ka lumenj dhe liqene. Ujrat nentokesore, per vet terenin (lartesine mbi nivelin e detit) jane larg siperfaqes. Per uljen e nivelit te tyre sherben nje kolektor.

Toka

Zona administrative e Kamzes shtrihet ne Ultësirën Perëndimore jo shumë larg bregdetit. Qendra e Kamzes ndodhet ne pjesen Veri-Perendimore te Tiranës dhe eshte rreth 11 km larg nga qendra e saj. Qendra e Kamzes ka kordinatat gjeografike 41° 22' 54" Veri, 19° 45' 37" Lindje.

Kamza kufizohet nga Veriu me zonen rurale te Fushe Krujes, ne jug me Paskuqanin, ne lindje me Zall Bastarin dhe perendim me Berxullin.

Ka nje pozite gjeografike rajonale mjaft te favorshme per zhvillimet ekonomiko-shoqërore. Terreni eshte kryesisht I sheshte me pjeresi te lehte te orientuar nga very –perendimi. Zona ne pjesen jugore eshte ne kuotat 80-90 m mbi nivelin e detit, ndersa zbret deri ne 45 m mbi nivelin e detit ne pjesen veriore, afer zones se Aeroportit te Rinasit.

Toka eshte tipike e livadhore. Keto toka karakterizohen nga horizonti A dhe B deri ne thellesine 50-60 cm. Tokat kane nje perbeje subargjilote te mesme.

Bimesia dhe gjallesat

Zona ku eshte vendosur fabrika, eshte zone urbane me bimesi te ulet spontane dhe peme kryesisht dekorative si drure ulliri, agrume dhe plepi etj.

Perpara viteve 90 ne kete zone zhvillohej aktivitet bujqesor. Nga bimesia spontane dominojne graminoret dhe cruciferet.

Nuk rezulton faune e pasur. Nga gjallesat qe hasen me shpesh jane qente, macet, miu ndersa nga shpendet kryesisht arabelat, kumurite e tj.

Vlen te permendet qe nuk ka specie te rrezikuara apo te mara ne mbrojtje te vecante ne kete zone. (Nuk perfshihen ne Librin e Kuq).

Kushtet gjeologjike

Shqiperia si formacion gjeologjik eshte eshte pjese perberese e rudhosjeve alpino – mesdhetare, pjese e degezimit Dinario-Albanio-Helenid. Ne bejme pjese te Albanidet. Kamza si zone e jashteme ben pjese ne Ultesiren Paramalore dhe ndodhet ne krahinen e Ultesires Perendimore e cila karakterizohet nga shkembinj te dobet qe i ben ato te paqendrueshem nga reshqitja. Kjo zone eshte pjese e sistemit neogjenik me argjila dhe konglomerat ranor. Zona karakterizohet nga brezi i tokes livadhore Livadhore dhe livadhore e hirte-kafe e cila vendoset mbi formacione sedimentare. Sasia e humusit eshte me e vogel se 2.4% dhe reaksioni lehtesisht acid.

Ne sheshin ku eshte ndertuar Fabrika marin pjese formacione te neogjenit te perfaqesuara nga nderthurje alevroitesh argjilore e ranore si dhe nga depozita aluvio-deluviale te kuarternit, trashesia e te cilave arin deri ne 25-30m.

Sizmiciteti

Trualli shqiptar eshte vendosur gjate kufirit te perplasjes se dy pllakave te medha qe levizin njera kundrejt tjetres, pllakes Euroaziatike dhe asaj Arabo-Afrikane duke perbere nje vater te perqendruar termetesh e cila preket me shpesh nga termete demtues.

Kamza eshte zone qe preket nga termetet dhe nga pikpamja sizmoteknike mund te goditet nga termete me magnitude $M_{max}=5.5-6$ grade Richter me intesitet deri ne 7 balle MKS-64 e cila shkakton carje ne mur dhe rezim copa suvash, por per objektet e uleta nuk parashikohn shqetesime. Mundesite e termeteve me shume balle jane te vogla rreth 20%.

Zhurmat

Trafiku eshte burimi kryesor i zhurmave ne mjediset pereth zones se fabrikes.

Trashegimia arkitektonike, arkeologjike dhe historike.

Ushtrimi i aktivitetit te fonderise se shkrirjes se skrapit te alumineve ndodhet ne zonen industriale te aprovuar me pare nga njesia vendore Kamez, si e tille nuk prek zonat turistike, arkitektonike, arkeologjike, kulturore dhe me interesa historike.

Teritori i fabrikes nuk eshte perfshire ne menyre direkte apo indirekte ne zone te mbrojtur si:

- a. Rezerve strikte natyrore/rezervat shkencor (kategoria e I)
- b. Park kombetar (kategoria e II)
- c. Monument natyror (kategoria e III)
- d. Rezervat natyror i menaxhuar/ zone e menaxhimit te habitateve dhe llojeve (kategoria e IV)
- e. Peisazh i mbrojtur (kategoria e V)
- f. Zone e mbrojtur e burimeve te menaxhuara/zone e mbrojtur me perdorim te shumefishte (kategoria e VI).

Zona ku eshte vendosur fabrika nuk ben pjese ne zonat e mbrojtura ne interes nderkombetar si ato qe perfshihen ne Konventen e Ramsarit, Konventen Boterore te Trashegimise etj.

Peisazhi dhe topografia

Peizazhi ne kete zone eshte brenda konturit estetik te nje prone. Ndertesa e fabrikes nuk dallohet per ndonje peizazh te vecante dhe as perdorim si mjedise per banoret.

Trualli ku eshte vendosur fabrika eshte i sheshte. Ndodhet ne zone industriale, prane nyjes se betonit. Ndersa ndertesat rreth e qark jane 1-2 kate.

Peisazhi ka pamjen e nje zone industriale te zhvilluar ne menyre te regullt.

Vlersimi i ndikimit te shkarkimeve ne ajer.

Ne kete fonderi si burim energjie perdoret energjia elektrike e siguruar kryesisht nga rjeti elektrik -OSHE. Gjate procesit te prodhimit perdoret energji elektrike. Ne raste shume te ralla te shkepujes se energjise, energjia do te sigurohet nga gjeneratoret me lende djegese.

Shkarkimet ne ajer qe gjenerohen nga linja teknologjike jane te paperfillleshme.

Shkarkime ne ajer kemi edhe nga djegja e karburantit te makinave. Duke patur parasysh kohen e perdorimit, kapacitetin prodhues, kohen e qendrimit te makinave per furnizim e tj, keto lloj shkarkimesh ne ajer nuk perbejne rrezik ndotje.

Vlersimi i ndikimi ne ujrat siperfaqesore

Sic e kemi permendur edhe me siper, rreth e qark fabrikes nuk kemi ujra siperfaqesore ne te cilat derdhen mbetjet si rezultat i prodhimit.

Vlersimi i ndikimit te shkarkimeve ne rrjetin e kanalizimeve.

Ne pjesen e mesiperme te ketij kapitulli kemi spieguar qe fabrika eshte e lidhur me rrjetin e kanalizimeve per shkarkimin e ujrave te bardha dhe te zeza. Kemi spieguar gjithashtu se tualetet ndodhen jashte fabrikes dhe se per largimin e ujrave te zeza ka kanalizime te cilat jane lidhur me sistemin e brendeshem te kanalizimeve.

Vlersimi i ndikimit te shkarkimeve ne ujrat nentokesor

Impianti i prodhimit nuk gjeneron shkarkime ne ujrat nentokesor. Sic e kemi pershkruar me lart, ujrat e ndotur (te larjes se fabrikes dhe te paisjeve) largohen nepermjet kanalizimeve. Kanalet jane ndertuar me materjal betoni, i cili nuk lejon filtrime ne toke.

Ndotja e tokes/ujrave nentokesor

Fonderia eshte e instaluar ne nje godine industriale, tip kapanon me konstruksione metalike mbi strukture betonarme. Objekti "Kapanon me Konstruksione Metalike" eshte konceptuar te jete i perbere nga kapanone me dy pjese ne forma drejtkendore ku secila pjese respektive do te jete me siperfaqe totale prej **1278** m², me dimensione respektive **48.1m** x **21m** dhe lartesi **13.45** metra, dhe 13.6m x 19.8m me lartesi 9.6m. Dyshemeja eshte prej betoni me nje shtrese 30 cm, e pa depertueshme nga ujrat. Ujrat e perdorur ne vaska gjate procesit teknologjik, jane te lidhura me rrjetin e kanalizimeve per shkarkim.

Sa me siper ujrat e larjes se dyshemesje dhe paisjeve nuk depertojne ne toke, per rjedhoje nuk paraqesin rezik per ndotje te tokes dhe ujrave nentokesor.

Ndikimi i zhurmes

Zhurma e shkaktuar nga paisjet teknologjike, per shkak te cilesise se tyre eshte minimale dhe nuk perben shqetesim per banoret e zones.

Per madhesine e zhurmes dhe ndikimin te punonjesit nuk jane bere matje.

Reduktimi i shkarkimit dhe sistemet e kontrollit

Fabrika/fonderia e shkrirjes se skojeve te aluminit, perdor paisje dhe teknologji te koheve te fundit te cilat kane mare ne konsiderate reduktimin e shkarkimeve. Sic e kemi thene dhe ne kapitujt e tjere me siper nga linja teknologjike nuk kemi shkarkime ne ajer ne forme tymrash ose aromash si rezultat i filtrave dhe ujit te perdorur si mjet per "shuarjen" e aromave dhe tymrave.

Energjia qe perdoret eshte energjia elektrike. Shkarkime te mundeshme ne ajer jane vetem nga pluhuri dhe djegja e karburantit te makinave.

Shkarkimet e ujrave behen ne sistemin e kanalizimeve i cili lidhet me rrjetin e kanalizimeve te zones. Gjithashtu edhe tualetet per shkarkimet jane te lidhura nepermjet kanalizimeve te brendeshme dhe rrjetin e zones.

Sasirat e ujit te perdorur per larjen e ambjenteve jane minimale dhe per nje periudhe te shkurter kohore.

Monitorimi

Monitorimi dhe marja e mostrave

Deri me tani janë kryer monitorime vizuale mbi ndotjet. Duke qenë se aktiviteti i prodhimit është gjithëvjetor do bëhet kujdes dhe do monitorohet që mos të tejkalohen normat e parashikuara në legjislacion për shkarkimet në mjedis, ajër, tokë dhe shkarkime të lengeta.

Monitorimi i cilesise se mjedisit

Monitorimi i cilesise se mjedisit sugjerohet të bëhet sipas Tabeles/Skedulit të Monitorimit Ambientale me poshte:

N/R	Cfar do monitorohet	Ku do monitorohet	Si do monitorohet	Kur do monitorohet	Perse do monitorohet	Perballimi i koston
	Faza e aktivitetit					
1	Hedhja e mbeturinave në vende të pa përshtatshme	Në amb. e fabrikes	Vizual	Gjate gjithë kohes	Emetime në ambient	EVEREST shpk
2	Matje e ndotjes së ajrit	Në amb. e fabrikes	vizuale	Një here në vit	Permb. e grimcave	EVEREST shpk
3	Ndotje të sipërfaqes	Në amb. e fabrikes	Vizual	Gjate gjithë kohes	Derdhie ambalazhi, Derdhie karburanti	EVEREST shpk
4	Ndotje nga uirat	Në amb. e fabrikes	Matje/analiza	Një here në vit	Ndotje e ujrave të larjes	EVEREST shpk
5	Mbrojta nga zjar. njerëz. oji.	Në amb. e fabrikes	Vizual	Gjate gjithë kohes	Mas. E sig nga zjari	EVEREST shpk
6	Mbrojtja nga zhurmat	Në amb. e fabrikes	vizuale	Dy here në vit	Monit. I zhurmave në fabrike	EVEREST shpk
6	Mbrojtja e nierezve	Në amb. e fabrikes	Vizual	Gjate gjithë kohes	Siguria e shëndetit Mas. sig. teknik	EVEREST shpk

Aspektet Mjedisore Dhe Teknikat Më Të Mira Të Disponueshme

Per zgjedhjen e linjes teknologjike pronari eshte bazuar ne disa kerkesa qe ndermjet tyre kane parasysh edhe reduktimin e efekteve negative ne mjedis.

1. Disa nga kerkesat qe ploteson linja teknologjike jane:
 - Eshte prodhim i viteve te fundit
 - Eshte ekonomike ne konsumin e energjise
 - Prodhon pak mbetje teknologjike
 - Teknologjia eshte miqesore me mjedisin pasi nuk krijon ndotje te ajrit, tokes dhe ujrave
2. Fabrika dhe linja teknologjike siguron
 - Funkionim normal te rrjetit te shkarkimeve te ujrave te bardha dhe te zeza.(ndertimi eshte i ri dhe me punime cilesore)
 - Rjeti i shkarkimit eshte i ndare
 - Pompa e ujit eshte e vogel ne volum por me kapacitet te larte
 - Mbetjet e ngurta evadohen nga kontraktori
3. Impianti nuk gjeneron mbetje domethenese.
4. Mbetjet urbane qe gjenerohen nga ky aktivitet nuk jane te rezikshme. Mbetjet urbane depozitohen ne piken e grumbullimit te caktuar nga njesia administrative dhe evadohen ne vendin e caktuar.
5. Ne fabrike punetoret jane te instruktuar per masat e mbrojtjes nga zjari dhe per regullat e sigurimit teknik gjate procesit te punes. Ne fabrike jane te afishuara rregullore, afishime te mbrojtjes nga zjari etj.

Programi I Permirsimit

Pronaret e EVEREST shpk., aktualisht kane pergatitur nje program per permiresimin e performances ambjentale te aktivitetit te fabrikes.

Ne kete program parashikon masa

- Teknike organizative
- Ekonomike
- Mjedisore

Parandalimi I Aksidenteve Dhe Reagimet Gjate Emergjencave

Me qellim minimizimin ne maksimum te efekteve negative mjedisore, qofte edhe potenciale dhe rritjes se efekteve pozitive ne mjedis, kompania do te marri masa si me poshte:

Per ruajtjen nga ndotjet siperfaqesore dhe te ujrave nentokesore.

Te survejoje regullisht funksionimin e rrjetit te brendeshem te kanalizimeve te ujrave te bardha e te zeza.

- Te kerkoje nga institucioni perkates dizifektimin periodik te tyre.
- Te mbaje ne kondicion teknik tubacionet e shkarkimit.
- Te evitroje derdhjet e karburantit dhe lubrikanteve
- Te mbaje te paster sheshin perballe fabrikes
- Te mirmbaje bimesine dekorative te mbjelle ne teritorin e fabrikes
- Te realizoje procesin e vetmonitorimit sipas percaktimit ne lejen mjedisore

Per trajtimin e mbetjeve te ngurta.

Te beje seleksionimin e mbetjeve te ngurta sipas llojit te materjalis perpara largimit te tyre ne vend depozitim.

Per minimizimin e zhurmave.

Te reklamoje me mjete figurative (tabela, shtypshkrime etj) ndalimin e burive per makinat e klienteve.

Per rruajtjen e ajrit nga ndotjet

Te minimizoj levizjen e makinave te transportit

Per eliminimin e rasteve aksidentale si zjare e tymra.

- Mbetet detyre e perhereshme
- Instruktimi i punonjesve per masat e mbrojtjes nga zjarri
- Reklamimi i kuadrit ligjor per mbrojtjen nga zjari,
- Ndalimi i pirjes se duhanit e tj.
- Ndrimi i fiksave sipas afateve te skadencave

Per regullat e sigurimit teknik

Te reklamohen ne vende te dukshme rregulloret e sigurimit teknik. Te behet instruktimi i punonjesve sipas afateve te percaktuara ne legjislacionin shqiptar etj.

Per mbrojtjen e tokes nga erozioni

Te mirmbaje sistemin e kanalizimeve. Te mari masa, sidomos gjate periudhes me reshje, per riparimin e ndonje shembje te mundeshme.

Masat emergjente te mara jashte orarit normal te punes.

Situata emergjente mund te shkaktohen nga zjarerat (shkendija elektrike), permytjet dhe nga ndonje termet i mundeshem. Per kete arsye do te hartohet nje plan i reagimit emergjent i cili te permbaje:

- a. Percaktimin e personit pergjegjes per ruajtjen e fabrikes
- b. Kontrollin dhe shkeputjen e energjise elektrike

- c. Kontrollin dhe shkeputjen e furnizimit me uje
- d. Sigurimin e nje sasie rere per shuarjen e zjarit ne rast emergjence
- e. Ndalimin e pirjes se duhanit
- f. Menyren e lajmerimit te pronarit dhe zjarfikseve.

Personi pergjegjes per marjen e masave te mesiperme eshte administratori i kompanise z. Sokol CUPI.

Plani i Menaxhimit të mbetjeve (PMM)

Ushtrimi i aktivitetit te fabrikes se shkrirjes se skorjeve te aluminit si aktivitet i kompanise EVEREST shpk, do të kërkojë menaxhimin e sasive te formave te ndryshme te mbetjeve. Për qëllimet e këtij plani, me termin mbetje do te kuptojme mbetjet ne forme te ngurte, te gazte dhe te lenget te derivuara nga aktiviteti i prodhimit, ngarkim, shkarkimit dhe transportit.

Objekti dhe qëllimi i planit

PMM identifikon mbetjet e derivuara nga procesi teknologjik i fabrikes, identifikon ndikimet e mundshme në mjedis nga përdorimi i materialeve dhe rekomandon masat e duhura për të zbutur këto ndikime.

PMM perfshine procedura të detajuara për menaxhimin dhe zbutjen e ndikimeve të mundshme të nxjerrjes, transportimit dhe menaxhimit të mbetjeve.

Ndikimet e mundshme të mëposhtme që do të përfshihen në PMM:

Shqetësimet nga zhurmat – ndikimet për shkak të zhurmës do të reduktohen nëpërmjet masave dhe rregullave te drejtimit dhe perdorimit te mjeteve të transportit.

Ndikimet mbi cilësinë e ajrit – Emetimet e pluhurave dhe aromave mund të reduktohen dhe të kontrollohen si duhet nëpërmjet menaxhimit me kujdes të qendrimit te mjeteve gjate furnizimit dhe transportit.

Ndikimet vizuale – Praktika më e mirë në lidhje me planifikimin e peizazhit është të garantohet ruajtja e normalitetit pamor të peizazhit përreth, dhe që vendndodhja nuk përbën një pengesë nga ana vizuale.

Ndotja e ujit – Rrjedhjet e ujit kanë potencialin për të ndotur sipërfaqen dhe burimet nëntokësore. Masat që zbusin ndikimin do të synojnë të kontrollojnë sistemimin e rrjedhjeve nga territori i f. Shqetësimet më të mëdha për ujërat sipërfaqësore jane kontrolli i rrjedhjeve të ujit të ngarkuara me sedimente, dhe parandalimi i erozionit.

Ndikimet mbi ujërat nëntokësore përgjithësisht lidhen me dherat dhe përbërjen gjeologjike nën të, sasitë e reshjeve, thellësinë e germimeve, afërsinë me pusët e zonës.

Menaxhimi i mbetjeve te ngurta – Hedhja e pakontrolluar e mbetjeve të ngurta, etj mund të ketë një ndikim të madh ne mjedis. Në përgjithësi, vendet e shkarkimit të këtyre mbetjeve duhet të jenë të mbrojtura mirë nga pamja e publikut dhe nuk duhet të paraqesin kërcënim për ujërat sipërfaqësore dhe burimet nënujore, nuk duhet të krijojnë shqetësime te banorët e zonës apo pësues të tjerë të ndikueshëm.

Kontrolli dhe menaxhimi i qarkullimit rrugor të përkohshëm. – Aktiviteti në vendodhje te objektit mund të sjelli për pasojë shtim të qarkullimit.

Efektet pozitive ne mjedis.

Nga pikpamja e peisazhit, ndertesat e fabrikes nuk luajne ndonje rrol perkeqesues, pasi jane ne zone me status industrial.

Kompania vete ka bere kujdes qe te krijoj ambjente e gjelberuara duke mbjelle peme dekorative dhe agrume. Duke krijuar efekt pozitiv dhe rekreacioni.

Ne kete fabrike si burim energjie perdoret energjia elektrike e siguruar kryesisht nga rrjeti elektrik. Ne raste shume te rralla te nderprerjes se energjise elektrike sigurohet nga gjeneratori.

Shkarkime ne ajer kemi edhe ne rastet kur punon gjeneratori dhe nga karburanti i makinave. Duke patur parasysh kohen e perdorimit, kapacitetin prodhues, kohen e qendrimit te makinave per furnizim e tj, keto lloj shkarkimesh ne ajer nuk perbejne rrezik ndotje.

Shkarkimet e ujrave te bardha dhe te zeza jane te sistemuara nepermjet kanalizimeve, pusetave dhe derdhen ne rjetin e kanalizimeve.

Ne fabrike ekzistojne mjetet e mbrojtjes kunder zjarit, personeli eshte i instruktuar.

Zhurmat nuk perbejne problem shqetesues per banoret perreth per aresye te distancave nga shtepite e banimit, dhe te procesit teknologjik.

Mbetjet e ngurta nga procesi teknologjik (skorie alumin) grumbullohen ne piken e grumbullimit ne fabrike, dhe per largimin e tyre firma ka lidhur kontrate per evadimin nga nje kontraktor tjetër.

Ne kompani zbatohen ne menyre rigoroze rregullat teknike dhe te sigurise ne pune.

Efektet negative ne mjedis.

Potencialisht, gjate aktivitetit te fabrikes mund te hasim ne efekte negative ne mjedis si:

- Ndotja siperfaqesore dhe e ujrave nentokesore si pasoje e difekteve te mundeshme ne rjetin e shkarkimeve te ujrave te zeza dhe te bardha.
- Ndotja e mjedisit si pasoje e zhurmave qe mund te shkarkohen nga motorat dhe burite e makinave.
- Ndotja e mjedisit nga mbeturinat e ngurta.
- Ndotje e ajrit.

Masat e mara per minimizimin e pasojave negative.

Me qellim minimizimin ne maksimum te efekteve negative mjedisore, qofte edhe potenciale, dhe ritjes se efekteve pozitive ne mjedis, administratori i EVEREST duhet/do te mare masa si me poshte:

1. Per ruajtjen nga ndotjet siperfaqesore dhe te ujrave nentokesore.

Te survejoje rregullisht funksionimin e rrjetit te kanalizimeve te ujrave te bardha e te zeza.

Ti pastroje rregullisht ato.

Te kryej dezinfektimin periodik te tyre.

Te mbaje te paster dhe te sistemuar ambjentet e jashteme te fabrikes.

Te mbjelle peme dhe te rise siperfaqen e ambjente te gjelberta ne teritorin e kompleksit

2. Per trajtimin e mbetjeve te ngurta.

Te seleksionioje mbetjet e ngurta sipas llojit te materjalit perpara largimit te tyre ne vend depozitim. Ti depozitoje ato ne vendin e caktuar nga njesia administrative

3. Per minimizimin e zhurmave.

Te reklamoje me mjete figurative (tabela, shtypshkrime etj) ndalimin e burive per makinat e klienteve.

4. Per rruajtjen e ajrit nga ndotjet

Te mbaje ne kondicion teknik kapanonet, vendilatoret dhe gjeneratoret.

6. Per eliminimin e rasteve aksidentale si zjare e tymra.

Te instruktoje punonjesit per masat e mbrojtjes nga zjarri, te reklamoje kuadrin ligjor per mbrojtjen nga zjari, ndalimin e pirjes se duhanit e tj.

6. Per regullat e sigurimit teknik

Te reklamoje ne vende te dukshme rregulloret e sigurimit teknik, te kryej ne menyre periodike instruktimin e punonjesve sipas afateve te percaktuara ne legjislacionin shqiptar etj.

Per monitorimin e vazhdueshem te ndotjeve.

Pronari ose administratori detyrohet te njoftoje rregullisht Axhensine Rajonale te Mjedisit per cdo eventualitet dhe problem qe paraqet rrezik per ndotje te mundeshme te ambientit.

Pronari detyrohet te vej ne dijeni Axhensine Rajonale te Mjedisit per cdo ndryshim apo shtesa te aktivitetit qe mund te kene ndikime ne mjedis.

Monitorimi i ndotjeve dhe efekteve te ketij aktiviteti do te realizohet nga struktura te specializuara dhe te dhenat do te raportohen prane Axhensise Rajonale te Mjedisit ne perputhje me detyrimet qe rjedhin nga ligjet dhe rregulloret ne fuqi. Pronari eshte i detyruar te krijoj kushtet e nevojshme per monitorimin e sakte dhe te vazhdueshem.

Pronari detyrohet te zbatoje te gjitha detyrimet qe rjedhin nga ligji Nr 9010 date 13.02.2003 "Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta", Ligjit Nr 9115 date 27.07.2003 "Per trajtimin mjedisor te ujrave te ndotura", Ligjit nr 8934 date 05.09.2002 "Per mbrojtjen e mjedisit" si dhe gjithe legjislacionin shqiptar ne lidhje me mjedisin.

Persa me siper ne kuader te procedurave te kompanise EVEREST shpk per **Leje Mjedisore te Tipit B per "Prodhim Dhe Perpunim I Metaleve , ID 2.5 pika b. Shkrirja dhe përftimi i aliazheve të metaleve joferrose (me ngjyrë) përfshirë produktet e rikuperuara (duke përfshirë rafinimin dhe derdhjen në fonderi);** Publiku mund te dergoje komentet dhe sugjerimet me shkrim apo forme elektronike ne adresen elektronike te AKM –se info@akm.gov.al.

Me respekt

Aelita Mani

Person I Autorizuar nga Kompania EVEREST shpk

Rr. Besim Imamai, nr.76, Tirane

mani_alb@yahoo.com

mob. 0697761386